

Rreziku i sëmundjes me kancer të zorrës së trashë ose të rektumit rritet nga stili jo i shëndetshëm i jetesës (lëvizja e pakët, obeziteti, ushqimi jo i shëndetshëm me shumë pak fibra, fruta dhe perime, konsumi i alkoolit dhe i duhanit). Mundësia e zhvillimit të kancerit të zorrës së trashë ose të rektumit është më e madhe te personat që kanë të afërm të drejtpërdrejtë me lidhje gjaku, të cilët e kanë pasur këtë sëmundje, por edhe te personat me sëmundje kronike me infeksione të zorrëve.

**Svit mund t'ju shpëtojë jetën edhe juve.
Për këtë arsye, përfshihuni në program dhe nxisni edhe të afërmit tuaj.**

Nëse dëshironi të mësoni diçka më shumë për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit, si dhe për Programin Svit, mund t'i gjeni shpjegimet në pikat e kontaktit të Svit-it në Shtëpitë e shëndetit, mund të kontaktoni me telefon, me faks ose me postë elektronike dhe të vizitoni faqen internet www.program-svit.si.

Svit 

Center Svit

P.P. 241, 1001 Ljubljana
telefoni 01/620 45 21
telefaksi 01/620 45 29
svit@nijz.si
www.program-svit.si

NIJZ Nacionalni inštitut
za javno zdravje

MINISTRIA E SHËNDETËSISËSË RS-SË | ENTI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I SLOVENISË
INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK

Svit 
Shpëton jetën



**PROGRAMI KOMBËTAR I DEPISTIMIT
DHE I ZBULIMIT TË HERSHËM TË
NDRYSHIMEVE PARAKANCEROZE, TË
KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË
DHE TË REKTUMIT**

Është koha të mendoni për veten.

Programi Svit

Programi kombëtar Svit është hartuar për burrat dhe gratë nga 50 deri 74 vjeç – ky është një program për depistimin dhe zbulimin e hershëm të ndryshimeve parakanceroze dhe të kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit.

Kur t'ju kontaktojnë për të marrë pjesë në këtë program, është mirë që ta pranoni ftesën dhe të përfshiheni në të.

Programi Svit mundëson zbulimin e gjakut të fshehur në feçe dhe, sipas nevojës, edhe kontrollin e detajuar të zorrëve, i cili shpjegon shkakun e gjakut të fshehur, dhe planifikon menjëherë mjekimin urgjent dhe efikas të ndryshimeve patologjike të zbuluara.

Programi Svit mund të shpëtojë së paku 200 banorë të Sllovenisë në vit dhe i shpëton shumë persona nga vuajtjet e rënda të shkaktuara nga kjo sëmundje tinëzare. Për shkak të mënjanimit në kohën e duhur të polipeve nga zorra e trashë dhe nga rektumi, çdo vit në Slloveni ka së paku 300 të sëmurë më pak nga kjo formë e kancerit

Suksesi i Programit Svit varet nga përfshirja sa më e madhe e atyre që janë ftuar të marrin pjesë dhe nga bashkëpunimi i tyre aktiv.

Çfarë është kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit?


Kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit është vrasës i heshtur tinëzar i banorëve të Sllovenisë, sepse çdo vit rreth 1400 persona sëmurën me këtë formë kanceri, kurse rreth 700 prej tyre vdesin nga kjo sëmundje.

Shumë persona të cilët kanë formën e hershme të kësaj sëmundjeje nuk janë aspak në dijeni të këtij fakti sepse ajo zhvillohet për një kohë të gjatë pa simptoma të dukshme.

Për këtë arsye të sëmurët shpesh vijnë tek mjeku kur tashmë është tepër vonë.

Më shpesh sëmurën meshkujt dhe femrat mbi 50 vjeç, por edhe të rinjtë. Kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit zhvillohet kryesisht nga ndryshimet parakanceroze në muret e zorrëve – në polipe.

Nëse polipet zbulohen në kohë dhe mënjanohen, kjo formë e kancerit mund të ndalohet. Nëse ndryshimet kanceroze zbulohen mjaft herët, mjekimi mund të jetë mjaft i suksesshëm dhe mund të ruhet jo vetëm jeta, por edhe cilësia e të jetuarit.



Njeriu mund të ketë kancer në zorrën e trashë ose në rektum disa vjet para se të shfaqen problemet shëndetësore serioze – por atëherë mund të jetë tepër vonë për mjekimin efikas. **Programi Svit mundëson që kjo formë e kancerit të zbulohet mjaft herët tek personat që akoma nuk kanë probleme të dukshme shëndetësore.**